



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura III**

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,  
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione  
Mbledhja nr. 48  
Prishtinë, më 25.11. 2009, në orën 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
Persona të Pagjetur dhe Peticione

**Morën pjesë:** Ismet Beqiri – kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviq,  
Nerxhivane Dauti, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Danush Ademi dhe Shpresa  
Murati.

**Mungoi:** Hajredin Hyseni për shkak se ishte i smuer .

**Mbledhjen e mbikëqyrën:** Rrezarta Ahmeti – KDI, Nexhat Shatri – Zyra e  
Presidentit dhe Elita Vokshi e Lejla Selimi - OSBE.

**Nga Stafi Mbështetës i Komisionit:** Rrahim Demaj – koordinator dhe Visar  
Krasniqi.

**Kryetari** konstatoi se ishin plotësuar kushtet, në bazë të Rregullores së punës të  
Kuvendit të Republikës së Kosovës, për mbajtjen e mbledhjes dhe propozoi këtë:

**R E N D I T E**

1. Miratimi i rendit të ditës,
- 2 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
- 3 Njoftim për Agjendën e vizitës studimore që do ta zhvillojë Komisioni  
në Poloni,
- 4 Të ndryshme.

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

**1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.**

*Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar.*

## **2. Njoftim për Agjendën e vizitës studimore që do ta zhvillojë Komisioni në Poloni**

**Ismet Beqiri**, kryetar - E ftoi Elita Vokshin – OSBE, ta merrte fjalën dhe t'i njoftonte anëtarët e Komisionit për përmbajtjen e Agjendës lidhur me vizitën zyrtare të anëtarëve të Komisionit në Poloni, që do të realizohet më 10.11. 2009. Ajo tha se janë kryer të gjitha formalitetet dhe se Komisioni do ta ketë një Agjendë të ngjeshur, duke filluar nga ora 9.00 deri në orën 17,00. Takim do të ketë me përfaqësuesit e Organizatës për Institucionet Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut (DHIR). Përveç takimeve të parapara në Agjendë, Komisioni do të takohet edhe me Komisionin për Legjislacion dhe për të Drejtat e Njeriut të Parlamentit të Polonisë (Sejmseli), në Varshavë. Në fund e falënderoi Stafin Mbështetës të Komisionit për ndihmën e ofruar rreth organizimit.

Kryetari e përshëndeti OSBE – në që u angazhua dhe e ndihmoi materialisht Komisionin për realizimin e vizitës studimore dhe kërkoi të jemi të kujdesshëm, në mënyrë që kjo vizitë të realizohet në nivelin e duhur.

Prandaj tha se Komisioni do të udhëtojë me këtë përbërje: Ismet Beqiri, Hajredin Hyseni, Radmilla Vujoviq, Nerxhivane Dauti, Naim Rrustemi, Sanije Aliaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Danush Ademi, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati, ndërsa nga Stafi i Administratës, Rrahim Demaj, koordinator dhe Visar Krasniqi.

Anëtarëve të Komisionit u janë dhënë disa konventa ndërkombëtare, në të cilat garantohej liritë dhe të drejtat e njeriut, si vijon:

- Deklaratën e Përgjithshme për të drejtat e njeriut,
- Konventën evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut dhe protokollat e saj,
- Konventën ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike të njeriut dhe protokollat e saj,
- Konventën për të drejtat e fëmijëve,
- Kartën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial,
- Kartën evropiane të gjuhëve rajonale dhe minoritare,
- Kornizën e Konventës së Këshillit të Evropës për mbrojtjen e minoriteteve,
- Konventën kundër torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jo njerëzore dhe poshtëruese.

Deputët: Ibrahim Makolli, Drita Maliq e Nerxhivane Dauti kërkuan sqarime lidhur me vizitën që ka të bëjë me këmbimin e valutave dhe me çështje të tjera të fushëveprimit të Komisionit. Me kënaqësi u përgjigj Elita Vokshi.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 25

Kryetari i Komisionit

-----  
*Ismet Beqiri*